



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:115815
Datë: 26.04.2024
Numri i dokumentit: 05628093

A.nr.1377/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ të paditësit A.H., me vendbanim në fshatin ... Komuna e ..., kundër të paditurës Ministria e Financave e Punës dhe e Transfereve-Departamenti i Pensioneve (MFPT-DP), me bazë juridike anulim i aktit administrativ, në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me dt.25.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET,** si e **pa bazuar,** kërkesëpadia e paditësit ... nga fshati Velikorekë, Komuna e ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohen vendimi numër 5806, i datës 13.04.2022 dhe të detyrohet e paditura që të njeh të drejtën në kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e dytë, ashtu sipas vendimit të datës 01.10.2018 dhe të kompensoi shumën e pa paguar në mënyrë retroaktive nga data e ndërprerjes së kompensimit me datë 16.09.2021 e deri në nxjerrjen e vendimit nga gjykata dhe të vazhdohet me kompensim në shumën prej 150 euro deri sa të plotësohen kushtet ligjore.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m i

Paditësi me datën 07.06.2022, ka parashtruar padi dhe lidhur me shqyrtimin e saj është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor, me datën 25.04.2024, konform nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prezencën e palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt,

Paditësi në padinë e parashtruar në gjykatë me datë 07.06.2022 ka theksuar se e paditura me aktvendimin kontestues të datës 13.04.2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditëses për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, për arsye se nuk janë plotësuar kushtet ligjore. Paditësi me tej ka shtuar se e paditura më rastin e marrjes së vendimit të kundërligjshëm të pa bazuar dhe të padrejtë, është ndërprerë pension për persona paraplegjik dhe tetraplegjik. Shihet qarte se nuk ka përmisime të gjendjes shëndetësore e këtë e dëshmojnë edhe raportet mjekësore të bashkangjitura padisë.

Paditësi në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit të ushtruar pranë kësaj gjykate, me të cilën kemi kërkuar që të anulohet Vendimi

me nr.5806, i dt.13.04.2022, për njohjen e të drejtës për persona paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe mendoi se Vendimi për refuzimin e ankesës nuk është në harmoni me Ligjin për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe mendoi se i njëjti vendim të anulohet dhe të merret vendim në favorin tim. Në këtë padi kam paraqitur prova dhe fakte për shkak të gjendjes sime shëndetësore jo të majtë, ku këmba dhe dora e djathtë është e pa lëvizshme dhe nuk mund të heci pa ndihmën e dikujt këtë e dëshmojnë edhe provat e bashkangjitura në këtë lëndë. Më tej theksoi se kërkon nga gjykata që gjendje shëndetësore dhe gjendja faktike të vërtetohet në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në gjykatë, dhe nuk kërkoi që të nxjerrët Ekspertizë Mjekësore për faktin se kemi shumë shpenzime dhe kërkoi që kjo çështje të përfundoi sa më shpejtë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se kërkoi nga gjykata që padia ime të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe të anulohet vendimi i të paditurës nr.5806, dt.13.04.2022, dhe të detyrohet e paditura që të më njeh të drejtën në kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në grupin e dytë, ashtu siç kam qenë duke e marrë sipas Vendimit të dt.01.10.2018, dhe të më kompensoj shumë e pa paguar në mënyrë retroaktive, nga data e ndërprerjes së kompensimit me dt.16.09.2021, e deri në nxjerrjen e këtij vendimi në gjykatë, dhe të vazhdohet me kompensimin në shumë prej 150 euro deri të plotësohen kushtet ligjore.

E paditura në përgjigjen në padi, të datës 08.12.2023 ka theksuar se e kundërshton në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe se Këshilli i Ankesave për Pensione me Aftësi të Kufizuar i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, dokumentacionin mjekësor që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit mjekësor të shkallës së parë, ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzues tani paditësi nuk është në harmoni me neni 7 pika 2 dhe neni 8 pika 2 të Ligjit nr.05/L- 067 duke vepruar sipas kërkesës së paditësit mori Vendim me të cilën refuzohet kërkesa e paditësit për njohjen e kësaj të drejte. Andaj, Komisioni i Ankesave pajtohet me vlerësimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë që nuk i plotëson kriteret për Pensionin e personave me Aftësi të kufizuar dhe si e tillë refuzohet Ankesa si e pa bazuar siç përcaktohet sipas dispozitave ligjore të nenit 7pika 2 dhe neni 8 pika 1 të Ligjit nr.05/L-067 Ministria e Punës dhe Mirëqenës Sociale nga Komisioni ekspert mjekësor nga shkalla e dytë, në seancën mjekësore kanë vlerësuar dokumentacionin në tërësi, ku për bazë kanë marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor si dhe raportet nga specialistet, ku është konstatuar se paditësi nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret sipas dispozitave ligjore të Ligjit nr.05/L-067. Vlerësimi i Komisionit mjekësor i përbërë nga tre anëtarësh, ekspert të dalluar, duke u dokumentacionit tjetër mjekësor, konstaton që kërkesa e paditësit të refuzohet, si e pa bazuar në anamnezën, analizës, raporteve specialiste, ekzaminimin objektiv dhe bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik ka administruar provat relevante dhe atë: Fletë lëshimi nga Klinika e neurologjisë, nr. Amzë 1091 dt.14.10.2020, Raporti specialistik – Psikiatrisë “Aura” 25.09.2020, Raporti specialistik nga Neurologu e dt.19.10.2021, 24.08.2021, Vendimi i dt.13.04.2022, Fletëlëshimi nga Klinika e neurologjisë nr. Amzë 1720/ dt.30.12.2019, 15.09.2020, Ekzaminimi radiologjik 23.12.2019, Raporti konziliar nr.772, dt.03.11.2021, dt.01.06.2022, Raporti specialistik nga Ordinanca spec. Neurologu 26.11.2021, Kopje e lejes së njoftimit të paditësit, Ankesa e paditësit e dt.11.04.2021, Vendimi i të paditurës i dt.16.09.2021, Vendimi mbi miratimin e kërkesës i dt.01.10.2018, Raporti specialistik neurologjisë 26.04.2021, Ekstrakti i gjendjes civile në emër të paditësit E 22587292, i dt.22.06.2018, Raporti konziliar me nr.772 dt. 24.05.2018, nga QKUK, Kontrata për shoqërimin e personit me aftësi të kufizuar, e vërtetuar tek noteri Skënder Dumani me nr. LRP 4138/20, e dt.24.07.2018, Certifikata e martesës ddt.26.07.2018 në emër të paditësit, Vlerësimi i komisionit për njohjen e statusit të të drejtëve

të personave paraplegjik dhe tetraplegjik në emër të paditësit, e dt.12.09.2018, Rivlerësimi i komisionit i dt.16.09.2021, Shqyrtimi i ankesave nga komisioni i dt.25.03.2022.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provat të administruara në shqyrtimin kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Në procedurën sipas ankesës, Komisioni për Ankesa i MPMS-së, me datën 13.04.2022, ka marrë vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar me arsyetimin se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për njohjen e të drejtës në kompensim për personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

Paditësi i pakënaqur me këtë aktvendim, ka ushtruar padi, duke kundërshtuar të njëjtin si të kundërligjshëm.

Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij vendimi, u bazua në **LIGJIN nr.05/L-067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK**, iu është referuar nenin 3 Përkufizimet, i cili ka përcaktuar:

1.1. Paraplegjikët – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme.

1.2. Tetraplegjikët – ose (kuadriplegjikët) – janë personat të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit të sistemit nervor qendror apo periferik kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të sipërme dhe të poshtme.

Nenit 7 Kompensimi, në paragrafin 1 dhe 2 të tij ka paraparë:

1 Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS.

2. Përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni

Nga provat relevante të cilat u administruan, gjykata vërejt se Komisioni përkatës mjekësor, i përcaktuar nga e paditura në bazë të Ligjit nr.05/L-067 për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, nga rivlerësimi Komisioni Mjekësor i dt.16.09.2021, gjykata vërejt se paditësit me rastin e rivlerësimit i ishte ndwrprerw e drejta në kompensim për persona paraplegjik dhe tetraplegjik, edhe nw rivlerësimin e dt. 25.03.2022 i kishte refuzuar paditësit kërkesën për kompensimin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik,. Po ashtu edhe komisioni mjekësor i angazhuar nga e paditura me rastin e shqyrtimit të ankesës së paditësit, përkatësisht në bazë të vlerësimit të datës 28.01.2022 i kishte refuzuar ankesën e paditësit si e pabazuar, përkatësisht kishte refuzuar njohjen e së drejtës në kompensim të personave paraplegjik dhe tetraplegjik me arsyetimin se nuk i plotëson kriteret për paraplegjik dhe tetraplegjik. Komisione të dyja këto që kishin pasur parasysh gjendjen e paditësit dhe shqyrtuar dokumentacionin mjekësor të parashtruar nga paditësi.

Prandaj me që paditësi nuk kishte ofruar as për gjykatën dëshmi të mjaftueshme mjekësore që do të vërtetonin se paditësi i plotëson kushtet ligjore për kompesnim për personat paraplegjik dh etetraplegjik,

kusht ky ligjor, për njohjen e të drejtës në kompensim, i përcaktuar nga Ligji nr.05/L-067 për statusi dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, përkatësisht nenit 3 dhe 7, gjykata vlerësoi se e paditura drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, drejta ka aplikuar të drejtën materiale dhe ligjin procedural kur ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar, dhe mbi këto arsye aktvendimi kontestues i të paditurës vlerësohet i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit të parashtruara në padi dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuara, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së nenit 3 dhe 7 Ligji nr.05/L-067 për statusi dhe të drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, është vërtetuar se i njëjti nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar, ndërsa në anën tjetër nga ana e tij në padi dhe në seancë nuk ishte propozuar eventualisht edhe nxjerrja e provës me ekspertizë të pavarur mjekësore, përkundër faktit se gjykata kishte njoftuar paditësin për mundësin e nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore, i njëjti në seancë ka deklaruar se nuk propozon për ekspertizë mjekësore, andaj gjykata mbi këto arsye, kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 64 të LKA-së.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5,6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.1377/22, dt.25.04.2024

Sekretarja Juridike
Nazife Sheholli

G j y q t a r j a
Valbona Gjonbalaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.